



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Lipjan shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Punëve Sociale
Institucioni	Komuna Lipjan
Nr. i Referencës	RN00009796
Kodi	RPC0003521
Data e njoftimit	22.08.2022
Afati për aplikim	12.09.2022 - 26.09.2022



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- 1.Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave.
- 2.Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës.
- 3.Shqyrton aplikacione në kohën e duhur dhe merr vendime në bazë të kriterëve që i përcakton Ligji mbi Skemën e Asistencës Sociale.
- 4.Llogarit saktë ndihmën që duhet t'i ndahet familjes në bazë të kriterëve të përcaktuara me ligj.
- 5.Shqyrton aplikacione në kohën e duhur dhe merr vendime në bazë të kriterëve që i përcakton Ligji mbi Skemën e Asistencës Sociale.
- 6.Përgatit lëndën nga aspekti teknik dhe administrativ për futjen e shënimeve në baze të dhënave.
- 7.Bën verifikimin e të gjithë shfrytëzuesve të ndihmës sociale si dhe përgatit lendet për komisionin mjekësor.
- 8.Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

-Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare - Fakulteti Psikologjisë, Pedagogjisë, Sociologjisë, Juridik me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.

-Kualifikime të posaçme formale:

-Përvoja e punës e kërkuar:

-Nuk kërkohet.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0003348	RN00009618	Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1	Profesional 3	6.5	Komuna Lipjan	Qendra për Punë Sociale / Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- -Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore,
- (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit).
- -Kopjet e dëshmisë së punësimit- vërtetimin e përvojës së punës, e njëjta duhet të verifikohet edhe me dëshmi shtesë nga Trusti Pensional i Kosovës apo vërtetim relevante nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- -Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.
- -Certifikatën që nuk jeni nën hetime (nga Gjykata).

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Njohuri profesionale në fushën sociale.
- Ligjin për shërbime sociale dhe familjare.
- Ligjin për skemën e ndihmave sociale.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

